



RAPORT MBI PROCESIN ZGJEDHOR

PËR ORGANET DREJTUESE TË UFSH-SË

PËR MANDATIN 01.01.2024 - 31.12.2028

Tiranë, korrik 2023

Me vendimin Nr. 1, datë 09.06.2023 të Këshillit Kombëtar, u miratuan datat e zhvillimit të zgjedhjeve për anëtarët e Këshillave Rajonalë, Presidentët dhe Zv. Presidentët e Këshillave Rajonalë, sipas grafikut të mëposhtëm:

Nr.	Këshilli Rajonal	Vendi	D. M. V	Orari i Votimit
1.	Berat	Berat	05.07.2023	12:00 – 17:00
2.	Dibër	Bulqizë	19.07.2023	12:00 – 17:00
3.	Durrës	Durrës	11.07.2023	12:00 – 17:00
4.	Elbasan	Elbasan	27.07.2023	12:00 – 17:00
5.	Fier	Fier	17.07.2023	12:00 – 17:00
6.	Gjirokastër	Gjirokaster	07.07.2023	12:00 – 17:00
7.	Korçë	Korçë	27.07.2023	12:00 – 17:00
8.	Kukës	Kukës	19.07.2023	12:00 – 17:00
9.	Lezhë	Lezhë	25.07.2023	12:00 – 17:00
10.	Shkodër	Shkodër	24.07.2023	12:00 – 17:00
11.	Tiranë	Tiranë	13.07.2023	10:00 – 18:00
12.	Vlorë	Vlorë	05.07.2023	12:00 – 17:00

Me vendimin Nr. 2, datë 09.06.2023 të Këshillit Kombëtar, u vendos që zgjedhjet për President dhe Zv. President të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, do të zhvillohen në datën 31 korrik 2023, ora 10:00.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidaturat për anëtarë të Këshillave Rajonalë, Zv. President të UFSH-së gjenden në nenin 31 të Statutit të UFSH-së.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidaturat për President të Këshillave Rajonalë dhe President të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, gjenden në nenin 9/1 të Ligjit 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrit e Farmacistëve në RSH”.

Njoftimi për zhvillimin e zgjedhjeve për organet drejtuese të Urdhrit të Farmacistëve u publikua në faqen zyrtare të UFSH-së si dhe në rrjetet sociale të Urdhrit, më datë 09.06.2023.

Referuar Vendimit Nr. 6, datë 09.06.2023, kandidatët për anëtarë të Këshillave Rajonalë, dorëzuan brenda datës 19 qershor 2023, ora 14:00, pranë Këshillave Rajonalë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular kandidimi;
- Kopje e ID

Referuar Vendimit Nr. 6, datë 09.06.2023, kandidatët për President të Këshillave Rajonalë, President dhe Zv. President të UFSH, dorëzuan brenda datës 19 qershor 2023, ora 14:00, pranë Zyrave Qendrore të UFSH-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular kandidimi (kliko këtu)
- Cv e shoqëruar me dokumentacioni provues;
- Kopje e ID;
- Kopje e lejës së ushtrimit të profesionit të lëshuar nga UFSH.

Shënim: Dokumentacioni për kandidatët për anëtarë të Këshillit Rajonal Tiranë, President dhe Zv. President të Këshillit Rajonal Tiranë, u dorëzua pranë Zyrave Qendrore të UFSH-së.

Referuar vendimit Nr. 5, datë 09.06.2023 të Këshillit Kombëtar, të drejtën për të votuar e kishin të gjitha anëtarët e UFSH-së, në rajonin ku figuronin, sipas ndryshimeve që kryen deri më datë 30.06.2023. Zyra e UFSH-së përgatiti listat e anëtarëve votues, sipas rajoneve përkatëse, të cilat iu përcollën secilit Këshill Rajonal. Anëtarësia e të 12 Këshillave Rajonalë u njoftua me emaili nga zyra e UFSH-së, në lidhje me orarin dhe vendin e votimit, një ditë përpara procesit të votimit.

Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave i ngritur me Vendim Nr. 4, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombëtar, i përbërë nga Znj. Diana Toma, Z. Ledjan Malaj dhe Znj. Pranvera Rroko,verifikoi secilën nga kandidaturat e paraqitura nëse plotësonte kriteret e përcaktuara në Ligj dhe në Statutin e UFSH-së, për tu kualifikuar si kandidat. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, Komisioni shpalli listën e kandidatëve për secilin rajon, në faqen zyrtare të UFSH-së. Listat u shpall jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve (referuar Rregullores së Zgjedhjeve). Gjithashtu, listat ju dërguan Presidentit të Këshillit Rajonal përkatës, për t'ia përcjellë anëtarëve të Komisionit të Administrimit të Votimit të rajonit të vet. Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturavë administroi gjithësej 113 aplikime. Kandidatët e skualifikuar për arsye të mos plotësimit të kriterëve u njoftuan në mënyrë shkresore nga komisioni, në lidhje me arsyet e skualifikimit.

Zyra e UFSH-së, gjatë gjithë procesit zgjedhor, ruajti kontakte të vazhdueshme me Presidentët e Këshillave Rajonale, si dhe ofroi asistencën e nevojshme si në aspektin ligjor ashtu dhe në aspektin logjistik.

PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL BERAT

Këshilli Rajonal Berat përbëhet nga 5 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Berat, aplikuan 6 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Berat, dy nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Berat. Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se të 6 kandidaturat e paraqitura plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut dhe në Ligj, për anëtarë të Këshillit Rajonal dhe 2 kandidaturat plotësonin kriteret për President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Berat ishin: Algert Demaj, Farbardha Shtrepi, Hamza Hysenbelliu, Hermon Bregu, Teuta Shtino Shehu dhe Trendelina Sahatçiu.

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Berat ishin: Algert Demaj dhe Hermon Bregu.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Berat u zhvilluan më datë 05.07.2023, pranë qendrës së Telemedicinës, Spitali Rajonal, Berat. Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues i zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishte Znj. Pranvera Rroko, Juriste e UFSH-së dhe Asistente e Presidentes. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombatar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Z. Afrim Plaka, President i Këshillit Rajonal Fier.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Berat, Z. Evis Karkanjozi – Kryetar, Albano Lirëza – Nënkyetar dhe Z. Ani Skëndo – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 5 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 5 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 88 fletë votimi për anëtar të Këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Berat, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të anëtarëve të Këshillit Rajonal Berat, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Berat, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Presidentit të Këshillit Rajonal Berat, 1 kuti votimi, 2 dhoma të fshehta dhe vulën e Këshillit Rajonal Berat. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 17:00. Në procesin e votimit ishte i angazhuar Presidenti i Këshillit Rajonal Berat, Z. Ali Demaj si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 88 anëtarë, nga të cilët 70 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 18 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 40 anëtarë ose 45,45% e anëtarëve (ose 57,14% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 70 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 40 fletë votimi nga të cilat 39 fletë votimi të vlefshme dhe një fletë votimi e pavlefshme. 48 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura.

Numri i votave ndërmjet kandidatëve u nda si mëposhtë: Z. Algert Demaj 29 vota, Znj. Fatbardha Shtrepi 30 vota, Z. Hamza Hysenbelliu 36 vota, Z. Hermon Bregu 37 vota, Znj. Teuta Shehu 35 vota dhe Znj. Trendelina Sahatciu 28 vota.

Anëtar të Këshillit Rajonal u zgjodhën: Z. Hermon Bregu, Znj. Teuta Shehu, Z. Hamza Hysenbelliu, Znj. Fatbardha Shtrepi, Z. Algert Demaj.



Në përfundim të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rajonal, Këshilli i sapozgjedhur zgjodhi Presidentin dhe Zv. Presidentin e Këshillit Rajonal Berat. Në procesin e votimit morrën pjesë 5 anëtarë të Këshillit Rajonal.

Ndërmjet dy kandidaturave për President të Këshillit Rajonal Berat, Z. Algert Demaj dhe Z. Hermon Bregu, me katër vota pro për Z. Hermon Bregu dhe një vote pro për Z. Algert Demaj, President i Këshillit Rajonal Berat u zgjodh Z. Hermon Bregu.

Ndërmjet dy kandidaturave për Zv. President, Znj. Fatbardha Shtrepi dhe Znj. Teuta Shehu, me 5 vota pro për Znj. Teuta Shehu dhe 0 vota për Znj. Fatbardha Shtrepi, Zv. President i Këshillit Rajonal Berat u zgjodh Znj. Teuta Shehu.

Procesi i votimit u zhvillua normalisht, i qetë dhe pa asnjë kontestim. Nga Komisioni i Administrimit të Votimit nuk u evidentua asnjë vërejtje.


PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL VLORË

Këshilli Rajonal Vlorë përbëhet nga 7 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Vlorë, aplikuan 8 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Vlorë, dy nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Vlorë. Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se të 8 kandidaturat e paraqitura plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut dhe në Ligj, për anëtarë të Këshillit Rajonal dhe 2 kandidaturat plotësonin kriteret për President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Vlorë ishin: Anisa Mina, Bilbil Rrapaj, Dhrino Lici, Elvis Bisholla, Eugen Xhaferaj, Florian Proko, Kozeta Meminaj, Laureta Gjoka (Livanaj).

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Vlorë ishin: Florian Proko dhe Kozeta Meminaj.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Vlorë u zhvilluan më datë 05.07.2023, pranë Hotel Tozo, Bulevardi Vlorë - skele, (Pranë Kali i Trojës), Vlorë. Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues i zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishte Znj. Mirsie Doka, Financiere e UFSH-së. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombatar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Znj. Diana Toma, Presidente e UFSH-së.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Vlorë, Z. Igli Rucaj – Kryetar, Znj. Anisa Mina – Nënkyetar dhe Z. Dhrino Lici – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 7 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 7 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 161 fletë votimi për anëtar të Këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Vlorë, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të anëtarëve të Këshillit Rajonal Vlorë, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Vlorë, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Presidentit të Këshillit Rajonal Vlorë, 1 kuti votimi, 2 dhoma të fshehta dhe vulën e Këshillit Rajonal Vlorë. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 17:00. Në procesin e votimit ishte e angazhuar Presidentja e Këshillit Rajonal Vlorë, Znj. Kozeta Meminaj si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 161 anëtarë, nga të cilët 118 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 43 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 36 anëtarë ose 22,36% e anëtarëve (ose 30.50% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 118 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 36 fletë votimi nga të cilat 34 fletë votimi të vlefshme dhe 2 fletë votimi të pavlefshme. 125 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura.

Numri i votava ndërmjet kandidatëve u nda si mëposhtë: Znj. Anisa Mina 28 vota, Z. Bilbil Rrapaj 20 vota, Z. Dhrino Lici 32 vota, Z. Elvis Bisholla 33 vota, Z. Eugen Xhaferaj 31 vota, Z. Florian Proko 30 vota, Znj. Kozeta Meminaj 32 vota dhe Znj. Laureta Gjoka 32 vota.

Anëtar të Këshillit Rajonal u zgjedhën: Z. Elvis Bisholla, Znj. Kozeta Meminaj, Z. Dhrino Lici, Znj. Laureta Gjoka, Z. Eugen Xhaferaj, Z. Florian Proko, Znj. Anisa Mina.



Në përfundim të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rajonal, Këshilli i sapozgjedhur zgjodhi Presidentin dhe Zv. Presidentin e Këshillit Rajonal Vlorë. Në procesin e votimit morrën pjesë 7 anëtarë të Këshillit Rajonal.

Ndërmjet dy kandidaturave për President të Këshillit Rajonal Vlorë, Z. Florian Proko dhe Znj. Kozeta Meminaj, me shtatë vota pro për Znj. Kozeta Meminaj dhe zero vota për Z. Florian Proko, President i Këshillit Rajonal Vlorë u zgjodh Znj. Kozeta Meminaj.

Ndërmjet dy kandidaturave për Zv. President, Z. Eugen Xhaferaj dhe Z. Dhrino Lici, me 4 vota pro për Z. Eugen Xhaferaj dhe 3 vota pro për Z. Dhrino Lici, Zv. President i Këshillit Rajonal Vlorë u zgjodh Z. Eugen Xhaferaj.

Procesi i votimit u zhvillua normalisht, i qetë dhe pa asnjë kontestim. Nga Komisioni i Administrimit të Votimit nuk u evidentua asnjë vërejtje.


PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL GJIROKASTËR

Këshilli Rajonal Gjirokastër përbëhet nga 5 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Gjirokastër, aplikuan 14 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Gjirokastër, dy nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Gjirokastër. Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se të 14 kandidaturat e paraqitura plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut dhe në Ligj, për anëtarë të Këshillit Rajonal dhe President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Gjirokastër ishin: Ada Prifti, Albana Braja, Albana Cabeli, Alketa Rexhaj, Aurela Bilibashi, Dorjan Shehu, Elsa Necka, Gramaoz Llapaj, Ilirjan Mulla, Ina Papa, Ina Spahiu, Klevi Isufi, Olsi Shutu, Silvana Mezini Korro.

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Gjirokastër ishin: Albana Braja dhe Silvana Mezini Korro.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Gjirokastër u zhvilluan më datë 07.07.2023, pranë Shkollës 9 vjeçare, Koto Hoxhi, Gjirokastër. Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues i zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishte Znj. Diana Toma, Presidente e UFSH-së dhe Znj. Mirsie Doka, Financiere e UFSH-së. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombëtar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Znj. Narvina Sinani, Përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Këshillin Kombëtar të UFSH-së, e cila nuk ishte prezent për të mbikëqyrur procesin zgjedhor.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Gjirokastër, Z. Vangjel Premto – Kryetar, Z. Hasan Shena – Nënkyetar dhe Z. Drini Muço – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 5 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 5 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 103 fletë votimi për anëtar të Këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Gjirokastër, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të anëtarëve të Këshillit Rajonal Gjirokastër, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Gjirokastër, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të

Presidentit të Këshillit Rajonal Gjirokastrë, dy kuti votimi, 2 dhoma të fshehta dhe vulën e Këshillit Rajonal Gjirokastrë. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 17:00. Në procesin e votimit ishte e angazhuar Presidentja e Këshillit Rajonal Gjirokastrë, Znj. Albana Çabeli (Baboçi) si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 103 anëtarë, nga të cilët 77 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 26 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 44 anëtarë ose 42,71% e anëtarëve (ose 57,14% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 77 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 44 fletë votimi nga të cilat 41 fletë votimi të vlefshme dhe 3 fletë votimi të pavlefshme. 59 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura.

Numri i votava ndërmjet kandidatëve u nda si mëposhtë: Znj. Ada Prifti 10 vota, Znj. Albana Braja 33 vota, Znj. Albana Çabeli 33 vota, Znj. Alketa Rexhaj 2 vota, Znj. Aurela Bilibashi 5 vota, Z. Dorjan Shehu 31 vota, Znj. Elisa Neçka 0 vota, Z. Gramoz Llapaj 2 vota, Z. Ilirjan Mulla 29 vota, Znj. Ina Papa 7 vota, Znj. Ina Spahiu 9 vota, Znj. Klevis Isufi 1 votë, Z. Olsi Shuti 9 vota dhe Znj. Silvana Korro 34 vota.

Anëtar të Këshillit Rajonal u zgjedhën: Znj. Silvana Korro, Znj. Albana Braja, Znj. Albana Çabeli, Z. Dorjan Shehu dhe Z. Ilirjan Mulla.



Në përfundim të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rajonal, Këshilli i sapozgjedhur zgjodhi Presidentin dhe Zv. Presidentin e Këshillit Rajonal Gjirokastrë. Në procesin e votimit morrën pjesë 5 anëtarë të Këshillit Rajonal.

Ndërmjet dy kandidaturave për President të Këshillit Rajonal Gjirokastrë, Znj. Albana Braja dhe Znj. Silvana Korro, me pesë vota pro për Znj. Albana Braja dhe zero vota për Znj. Silvana Korro, President i Këshillit Rajonal Gjirokastrë u zgjodh Znj. Albana Braja.

Ndërmjet dy kandidaturave për Zv. President, Znj. Albana Çabeli dhe Z. Dorjan Shehu, me 4 vota pro për Z. Dorjan Shehu dhe 1 votë pro për Znj. Albana Çabeli, Zv. President i Këshillit Rajonal Gjirokatër u zgjodh Z. Dorjan Shehu.

Procesi i votimit u zhvillua normalisht, i qetë dhe pa asnjë kontestim. Nga Komisioni i Administrimit të Votimit nuk u evidentua asnjë vërejtje.

PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL DURRËS

Këshilli Rajonal Durrës përbëhet nga 7 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Durrës, aplikuan në total 14 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Durrës, dy nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Durrës. Njëri nga kandidatët aplikoi për anëtarë të Këshillit Rajonal Durrës, President të Këshillit Rajonal Durrës dhe Zv. President të UFSH-së. Duke qenë se funksioni i Presidentit të Këshillit Rajonal Durrës dhe Zv. Presidentit të UFSH-së, janë funksione të papajtueshëm me njëri tjetrin, nuk mund të ushtrohen njëkohësisht nga i njëjti person, Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave i kërkoi kandidatit të zgjedhë ndërmjet kandidimit si anëtar të Këshillit Rajonal Durrës dhe President të Këshillit Rajonal Durrës apo për anëtar të Këshillit Rajonal Durrës dhe Zv. President të UFSH-së. Kandidati nuk ushtroi të drejtën për të zgjedhur ndërmjet dy aplikimeve të paraqitura për President të Këshillit Rajonal Durrës dhe Zv. President të UFSH-së, për këtë arsye Komisioni vendosi mos marrjen në konsideratë të aplikimeve për President të Këshillit Rajonal Durrës dhe Zv. President të UFSH-së.

Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se të 14 kandidaturat e paraqitura plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut për anëtar të Këshillit Rajonal dhe 2 kandidaturat e tjera plotësonin kriteret e vendosura në ligj për President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Durrës ishin: Agim Kodra, Alban Sula, Ajeda Malaj, Dorina Vasjari, Eva Lekli, Gazmir Mata, Ilir Troplini, Jurgen Babamusta, Markelio Stanaj, Raimond Bineri, Sadik Muka, Suela Domi, Shefqet Peza, Tanja Spahiu.

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Durrës ishin: Jurgen Babamusta dhe Sadik Muka.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Durrës u zhvilluan më datë 11.07.2023, pranë Qendrës Tregtare "Blue Star", salla e Konferencave, kati 4, Durrës. Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues të zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishin Znj. Diana Toma, Presidente e UFSH-së, Znj. Mirsie Doka, Financiere e UFSH-së dhe Znj. Artida Pashaj, Specialiste e regjistrimit pranë UFSH-së. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombëtar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Z. Ledjan Malaj, Përfaqësues i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, në Këshillin Kombëtar të UFSH-së.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Durrës Znj. Marjeta Isaku – Kryetar, Znj. Majda Këlliçi – Nënkyetar dhe Znj. Arziko Musa – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 7 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 7 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 398 fletë votimi për anëtar të Këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Durrës, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të anëtarëve të Këshillit Rajonal Durrës, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Durrës, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Presidentit të Këshillit Rajonal Durrës, dy kuti votimi, 2 dhoma të fshehta dhe vulën e Këshillit Rajonal Durrës. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 17:00. Në procesin e votimit ishte e angazhuar Presidentja e Këshillit Rajonal Durrës, Znj. Tanja Spahiu, Zv. Presidenti i UFSH-së Z. Jurgen Babamusta si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 398 anëtarë, nga të cilët 309 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 89 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 221 anëtarë ose 55.52% e anëtarëve (ose 71.52% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 309 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 221 fletë votimi nga të cilat 208 fletë votimi të vlefshme dhe 13 fletë votimi të pavlefshme. 177 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura.

Numri i votava ndërmjet kandidatëve u nda si mëposhtë: Z. Agim Kodra 86 vota, Z. Alban Sula 83 vota, Znj. Ajea Malaj 82 vota, Znj. Dorina Vasjari 82 vota, Znj. Eva Lekli 82 vota, Z. Gazmir Mata 85 vota, Z. Ilir Troplini 126 vota, Z. Jurgen Babamusta 133 vota, Z. Markelio Stanaj 121 vota, Z. Raimond Bineri 119 vota, Z. Sadik Muka 86 vota, Znj. Suela Domi 123 vota, Z. Shefqet Peza 120 vota dhe Znj. Tanja Spahiu 128 vota.

Anëtar të Këshillit Rajonal u zgjedhën: Z. Jurgen Babamusta, Znj. Tanja Spahiu, Z. Ilir Troplini, Znj. Suela Domi, Z. Markelio Stanaj, Z. Shefqet Peza, Z. Raimond Bineri.



Në përfundim të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rajonal, Këshilli i sapozgjedhur zgjodhi Presidentin dhe Zv. Presidentin e Këshillit Rajonal Durrës. Në procesin e votimit morrën pjesë 7 anëtarë të Këshillit Rajonal.

Ndërmjet dy kandidaturave për President të Këshillit Rajonal Durrës, Z. Jurgen Babamusta dhe Z. Sadik Muka, me shtatë vota pro për Z. Jurgen Babamusta dhe zero vota për Z. Sadik Muka, President i Këshillit Rajonal Durrës u zgjodh Z. Jurgen Babamusta.

Ndërmjet dy kandidaturave për Zv. President, Znj. Suela Domi dhe Z. Rajmond Bineri, me 4 vota pro për Znj. Suela Domi dhe 3 votë pro për Z. Rajmond Bineri, Zv. President i Këshillit Rajonal Durrës u zgjodh Znj. Suela Domi.

Procesi i votimit u zhvillua normalisht, i qetë dhe pa asnjë kontestim. Nga Komisioni i Administrimit të Votimit nuk u evidentua asnjë vërejtje.

PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL TIRANË

Këshilli Rajonal Tiranë përbëhet nga 9 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Tiranë, aplikuan në total 14 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Tiranë, tre nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Tiranë. Njëri nga kandidatët nuk plotësonte eksperiencën 15 vjecare për të qenë kandidat për President të Këshillit Rajonal, prandaj nga Komisioni u kualifikua si kandidat vetëm për anëtar të Këshillit Rajonal Tiranë. Po ashtu njëri nga kandidatët nuk plotësonte kriterin e 5 viteve anëtar i UFSH-së, për tu kualifikuar si kandidat për anëtar të Këshillit Rajonal.

Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se nga 14 kandidaturat e paraqitura 13 plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut për anëtar të Këshillit Rajonal dhe 2 kandidatura plotësonin kriteret e vendosura në ligj për President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Tiranë ishin: Agron Gjini, Ardi Derivshi, Arjan Logu, Armand Koni, Besa Dogjani, Besarije Shehu, Defrim Goma, Edvin Zenelaj, Endri Manxhari, Florjan Marku, Helena Hazizaj, Laurela Zani, Yllka Prifti.

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Tiranë ishin: Agron Gjini dhe Laurela Zani.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Tiranë u zhvilluan më datë 13.07.2023, pranë zyrave Qëndrore të UFSH-së. Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues të zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishin Znj. Diana Toma, Presidente e UFSH-së, Znj. Mirsie Doka, Financiere e UFSH-së, Znj. Pranvera Rroko, Juriste e UFSH-së dhe Znj. Artida Pashaj, Specialiste e Regjistrimit pranë UFSH-së. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombëtar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Z. Jurgen Babamusta, Zv. President i UFSH-së.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Tiranë Z. Orion Jucja – Kryetar, Znj. Nevjana Bakaj – Nënkyetar dhe Znj. Eni Bushi (Beci) – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 9 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 9 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 2493 fletë votimi për anëtar të këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Tiranë, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për

shpalljen fitues të anëtarëve të Këshillit Rajonal Tiranë, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Tiranë, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Presidentit të Këshillit Rajonal Tiranë, dy kuti votimi, 2 dhoma të fshehta dhe vulën e Këshillit Rajonal Tiranë. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 10:00 dhe përfundoi në orën 18:00. Në procesin e votimit ishte e angazhuar Presidentja e Këshillit Rajonal Tiranë, Znj. Laurela Zani, si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 2493 anëtarë, nga të cilët 1707 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 786 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 272 anëtarë ose 10.91% e anëtarëve (ose 15.93% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 1707 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 272 fletë votimi nga të cilat 263 fletë votimi të vlefshme dhe 9 fletë votimi të pavlefshme. 2221 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura, ndërsa dy fletë rezultuan të dëmtuara.

Numri i votava ndërmjet kandidatëve u nda si mëposhtë: Z. Agron Gjini 218 vota, Z. Ardi Dervishi 188 vota, Z. Ajon Logu 136 vota, Z. Armand Koni 154 vota, Znj. Besa Dogjani 222 vota, Znj. Besarije Shehu 155 vota, Z. Defrim Goma 249 vota, Z. Edvin Zenelaj 159 vota, Z. Endri Manxhari 101 vota, Z. Florjan Marku 186 vota, Znj. Helena Hazizaj 147 vota, Znj. Laurela Zani 236 vota, dhe Znj. Yllka Prifti 216 vota.

Anëtar të Këshillit Rajonal u zgjedhën: Z. Defrim Goma, Znj. Laurela Zani, Znj. Besa Dogjani, Z. Agron Gjini, Znj. Yllka Prifti, Z. Ardi Dervishi, Z. Florjan Marku, Z. Edvin Zenelaj dhe Znj. Besarije Shehu.



Në përfundim të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rajonal, Këshilli i sapozgjedhur zgjodhi Presidentin dhe Zv. Presidentin e Këshillit Rajonal Tiranë. Në procesin e votimit morrën pjesë 8 anëtarë të Këshillit Rajonal.

Ndërmjet dy kandidaturave për President të Këshillit Rajonal Tiranë, Z. Agron Gjini dhe Znj. Laurela Zani, me shtatë vota pro për Znj. Laurela Zani dhe 1 votë për Z. Agron Gjini, President i Këshillit Rajonal Tiranë u zgjodh Znj. Laurela Zani.

Ndërmjet dy kandidaturave për Zv. President, Znj. Besa Dogjani dhe Znj. Yllka Prifti, me 7 vota pro për Znj. Besa Dogjani dhe 1 votë pro për Znj. Yllka Prifti, Zv. President i Këshillit Rajonal Tiranë u zgjodh Znj. Besa Dogjani.

Procesi i votimit u zhvillua normalisht, i qetë dhe pa asnjë kontestim. Nga Komisioni i Administrimit të Votimit nuk u evidentua asnjë vërejtje.

PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL FIER

Këshilli Rajonal Fier përbëhet nga 7 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Fier, aplikuan në total 13 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Fier, tre nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Fier. Njëri nga kandidatët ushtronte njëkohësisht detyrën e kryetarit të Degës pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Lushnjë. Referuar nenit 31 të Statutit të UFSH-së, pika 9, kandidaturat për anëtar të Këshillit Kombëtar dhe të Këshillave Rajonale duhet të mos jenë të zgjedhur apo të emëruar në detyra funksionale drejtuese shtetërore. Për sa më sipër Komisioni nuk e kualifikoi si kandidat për anëtar dhe President të Këshillit Rajonal Fier.

Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se nga 13 kandidaturat e paraqitura, 12 plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut për anëtar të Këshillit Rajonal dhe 2 kandidatura plotësonin kriteret e vendosura në ligj për President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Fier ishin: Afrim Plaka, Anxhela Xhemali, Armando Musko, Blerta Gjeci, Dashamir Banda, Gentjana Hykaj, Gëzim Iliazi, Klara Bakiasi, Klodian Lushi, Kozeta Kadriu, Laurenc Aliaj, Ozrenka Leka

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Fier ishin: Afrim Plaka dhe Laurenc Aliaj.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Fier u zhvilluan më datë 17.07.2023, pranë Sallës së mbledhjeve të poliklinikës Fier (kati i tretë). Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues të zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishin Znj. Mirsie Doka, Financiere e UFSH-së dhe Znj. Pranvera Rroko, Juriste e UFSH-së. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombëtar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Z. Ali Demaj, President i Këshillit Rajonal Berat.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Fier: Vladimir Sanxhaku – Kryetar, Artan Zenelaj – nenkryetar, Ardi Aliaj – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 7 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 7 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 300 fletë votimi për anëtar të këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Fier, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues

të anëtarëve të Këshillit Rajonal Fier, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Fier, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Presidentit të Këshillit Rajonal Fier, 1 kuti votimi, 2 dhoma të fshehta dhe vulën e Këshillit Rajonal Fier. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 17:00. Në procesin e votimit ishte i angazhuar Presidenti i Këshillit Rajonal Fier, Z. Afrim Plaka, si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 300 anëtarë, nga të cilët 227 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 73 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 82 anëtarë ose 27.33% e anëtarëve (ose 36.12% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 227 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 82 fletë votimi nga të cilat 80 fletë votimi të vlefshme dhe 2 fletë votimi të pavlefshme. 217 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura, ndërsa një fletë rezultoi e dëmtuar.

Numri i votave ndërmjet kandidatëve u nda si mëposhtë: Z. Afrim Plaka 77 vota, Znj. Anxhela Xhemali 65 vota, Z. Armando Muska 33 vota, Znj. Blerta Gjeçi 50 vota, Z. Dashmir Banda 47 vota, Znj. Gentjana Hykaj 34 vota, Z. Gëzim Iliazi 46 vota, Znj. Klara Bakiasi 34 vota, Z. Klodian Lushi 31 vota, Znj. Kozeta Kadriu 37 vota, Z. Laurenc Aliaj 51 vota dhe Znj. Ozrenka Leka 56 vota.

Anëtar të Këshillit Rajonal u zgjedhën: Z. Afrim Plaka, Znj. Anxhela Xhemali, Znj. Ozrenka Leka, Z. Laurenc Aliaj, Znj. Blerta Gjeçi, Z. Dashmir Banda, Z. Gëzim Iliazi.



Në përfundim të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rajonal, Këshilli i sapozgjedhur zgjodhi Presidentin dhe Zv. Presidentin e Këshillit Rajonal Fier. Në procesin e votimit morrën pjesë 6 anëtarë të Këshillit Rajonal.

Ndërmjet dy kandidaturave për President të Këshillit Rajonal Fier, Z. Afrim Plaka dhe Z. Laurenc Aliaj, me pesë vota pro për Z. Afrim Plaka dhe 1 votë për Z. Laurenc Aliaj, President i Këshillit Rajonal Fier u zgjodh Z. Afrim Plaka.

Ndërmjet dy kandidaturave për Zv. President, Znj. Anxhela Xhemali dhe Z. Dashamir Banda, me pesë vota pro për Znj. Znj. Anxhela Xhemali dhe një votë pro për Z. Dashamir Banda, Zv. President i Këshillit Rajonal Fier u zgjodh Znj. Znj. Anxhela Xhemali.

Procesi i votimit u zhvillua normalisht, i qetë dhe pa asnjë kontestim. Nga Komisioni i Administrimit të Votimit nuk u evidentua asnjë vërejtje.

PROCESI ZGJEDHOR NË KËSHILLIN RAJONAL DIBËR

Këshilli Rajonal Dibër përbëhet nga 5 anëtarë. Në Këshillin Rajonal Dibër, aplikuan në total 6 kandidatë për anëtarë të Këshillit Rajonal Dibër, dy nga të cilët kandiduan dhe për President të Këshillit Rajonal Dibër.

Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave vlerësoi se nga 6 kandidaturat e paraqitura 6 kandidatura plotësonin kriteret e përcaktuara në Statut për anëtar të Këshillit Rajonal dhe 2 kandidatura plotësonin kriteret e vendosura në ligj për President të Këshillit Rajonal.

Kandidatët që plotësuan kriteret për anëtarë të Këshillit Rajonal Dibër ishin: Dition Hoxha, Endrit Meta, Lime Canaj, Mahir Halili, Nazife Bica, Sonila Losha.

Kandidatët që plotësuan kriteret për President të Këshillit Rajonal Dibër ishin: Lime Canaj dhe Sonila Losha.

Zgjedhjet në Këshillin Rajonal Dibër u zhvilluan më datë 19.07.2023, pranë Lokal Veep Beer (pranë bingos së vjetër), Bulqizë. Referuar Urdhrit Nr. 559, datë 29.06.2023, përfaqësues i zyrës së UFSH-së në këto zgjedhje ishte Znj. Pranvera Rroko, Juriste e UFSH-së. Referuar Vendimit Nr. 3, datë 09.06.2023, të Këshillit Kombëtar, i deleguar i Këshillit Kombëtar ishte Z. Saimir Mergjyli, President i Këshillit Rajonal Lezhë.



Zgjedhjet u administruan nga Komisioni i Administrimit të Votimit i përbërë nga 3 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal Dibër: Z. Hitler Kurti – Kryetar, Znj. Bendisa Hoxha - Nenkryetar, Znj. Klea Kurti – Anëtar.

Komisioni i Administrimit të Votimit morri në dorëzim nga zyra e UFSH-së 5 fletë votimi për President të Këshillit Rajonal, 5 fletë votimi për Zv. President të Këshillit Rajonal, 63 fletë votimi për anëtar të këshillit Rajonal, listën e zgjedhësve të Rajonit Dibër, 3 kopje Procesverbal Mod V/3, 3 kopje Procesverbal Mod V/4, 3 kopje Procesverbal Mod V/5, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të anëtarëve të Këshillit Rajonal Dibër, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Zv. Presidentit të Këshillit Rajonal Dibër, 3 kopje Vendim për shpalljen fitues të Presidentit të Këshillit Rajonal Dibër, 1 kuti votimi, 1 dhomë të fshehtë dhe vulën e Këshillit Rajonal Dibër. Materialet ju kthyen përsëri zyrës së UFSH-së në përfundim të procesit.

Procesi i Votimit filloi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 17:00. Në procesin e votimit ishte i angazhuar Presidenti i Këshillit Rajonal Dibër, Z. Kujtim Hoxha, si dhe anëtarët e Këshillit Rajonal.

Anëtarësia e Këshillit Rajonal përbëhet nga 63 anëtarë, nga të cilët 52 anëtarë ushtrojnë profesionin, ndërsa 11 anëtarë janë pasivë, nuk ushtrojnë profesionin. Në procesin e votimit morrën pjesë 22 anëtarë ose 34.92% e anëtarëve (ose 42.30% e anëtarëve nëse do llogaritet përqindja e 52 anëtarë që janë aktivë).

Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i Administrimit të Votimit, nisi procesin e numërimit të votave. Në kutinë e votimit u gjendën 22 fletë votimi nga të cilat 22 fletë votimi të vlefshme dhe 0 fletë votimi të pavlefshme. 40 fletë votimi u kthyen pranë zyrave të UFSH-së të pa përdorura, ndërsa një fletë rezultoi e dëmtuara.

